



Titulli i projektit

Parku rekreativ i Luginës së Shërimit.

Tipi i projektit

Shërbime Publike

Vendndodhja e projektit

Bashkia Peshkopi, Komuna Melan, komuna Tomin

Buxheti i paravlerësuar

150,000 Euro

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Qyteti i Peshkopisë, me 20000 banorë, ka mungesë të hapësirave të gjelbërta dhe parqeve rekreative, megjithëse shtrihet në një pozicion të favorshëm gjeografik, buzë luginës së përroit të Llixhave (i famshëm për ujërat termale me veti shëruese), rrethuar me kodra të pasura me bukuri monumentale natyrore, ku gjenden dhe rrënojat e kishave dhe manastireve të vjetra (nga ku ka marrë dhe emrin Peshkopia).

Pushuesit e shumë që frekuentojnë Llixhat (12000 pushues në vit), qytetarët e Peshkopisë, të rinjtë dhe të rejat që janë të apasionuar për të shëtitur, pushuar, luajtur dhe kaluar kohën e lirë në parqe, nuk kanë asnjë mundësi në Peshkopi.

Lugina e Përroit të Peshkopisë është shumë e favorshme për t'u kthyer në një park rekreativ, pasi është afër qytetit dhe ka hapësirat e nevojshme dhe atraksionet natyrore dhe historike. Shtrirja në territorin e parkut natyror Korab-Korritnik dhe bashkimi i NJQV Melan, Tomin dhe Peshkopi, krijojnë një mundësi të mirë ligjore dhe institucionale për krijimin e këtij parku.

Qëllimi/et specifik të projektit

Objekti i përgjithshëm: Përmirësimi i cilësisë së jetesës së banorëve të Peshkopisë, duke krijuar ambiente çlodhëse dhe rekreative.

Objekti specifik: Ngritja e parkut rekreativ të Luginës së Shërimit në rrethinat e Peshkopisë, me një sipërfaqe prej 50 ha, me stola dhe parqe, shtigje për të ecur në këmbë, me parkun arkeologjik të rrënojave të kishave, me fusha dhe ambiente sportive si dhe me ambiente të tjera shërbimesh, brenda vitit 2019.

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

Rezultati i pritshëm 1: 300 familjet e lagjes Llixha janë të ndërgjegjësuar dhe të angazhuar në prishjen e mureve përgjatë rrugës kryesore dhe krijimin e gardheve të gjelbërta.

Rezultati i pritshëm 2: Ambient natyror çlodhës i sistemuar dhe i përshtatshëm me stola pushimi, 10 ha pyll dhe 8 km shtigje për ecje në këmbë.

Rezultati i pritshëm 3: Ambiente sportive me fusha mikse futbollit, basketbollit, volejbollit dhe ambiente për ngjitje alpinizmi janë ndërtuar.

Rezultati i pritshëm 4: Parku arkeologjik i rrënojave të kishave të Peshkopisë i zbuluar dhe në funksion të vizitorëve.

PROJEKTI 5



program i zonave funksionale

pzf

Aktivitetet e projektit

- 1 Takime me banorët e lagjes Llixha
- 2 Prishja e avllive dhe ndërtimi i gardheve të gjelbërt
- 3 Ndërtimi i shtigjeve
- 4 Pastrimi i pyjeve dhe mbjellja e pemëve te reja
- 5 Vendosija e stolave dhe lulishteve
- 6 Ndërtimi i ambjenteteve sportive
- 7 Promovimi

Maturimi i projektit

Bashkia e Peshkopisë ka një studim fizibiliteti për parkun rekreativ, të hartuar nga një grup specialistësh. Gjithashtu, në vitin 2013-2014 është punuar për planin e studimit për parkun Korab –Korritnik, pjesë i të cilit është edhe parku rekreativ i Luginës së Shërimit. Megjithatë, projekti i plotë teknik nuk është detajuar. Ndaj kërkohet ngritja e një grupi pune me specialistë për secilën fushë.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Bashkia e ardhshme do të jetë aktori përgjegjës për këtë projekt. Ajo do të hartojë dhe zbatojë planin për parkun rekreativ, i cili do të jetë pjesë e shërbimeve të bashkisë. Ajo do të jetë përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe menaxhimin e tij, çështje që do të jenë pjesë e buxhetit të bashkisë. Për këtë projekt Bashkia do të bashkëpunojë me komunitetin dhe OJF që kanë në fokus mjedisin.

Kostot e projektit

Kostoja totale e projektit është 150,000 Euro.